

23. Vejushat që jetojnë në kulturat ku gratë shpesh fajësohen për vdekjen e burrave të tyre. Lutuni gjithashtu për ato gra që janë të detyruara të martohen me të afërmit e burrave të tyre të vdekur.

24. Gratë beqare të krishtera që janë nën presion nga familjet e tyre për t'u martuar me jobesimtarë.

25. Çiftet e krishtera të studiojnë Fjalën e Perëndisë, të mësojnë përmendësh Shkrimin, dhe të duan dhe respektojnë njëri-tjetrin duke ndjekur parimet biblike në zhvillimin e marrëdhënieve të tyre.

26. Mundësi lokale të punësimit në mënyrë që baballarët të mund të sigurojnë nevojat e familjeve të tyre dhe të mos u duhet të largohen nga ata për të gjetur punë.

27. Vejushat, familjet e bashkëshortëve të cilave nuk e njohin të drejtën e një gruaje e cila mbetet gjallë për të mbajtur fëmijët e çiftit dhe për të trashëguar shtëpinë dhe tokën e çiftit.

28. Bashkëshortët dhe gratë të kenë një varësi të përlur ndaj drejtimit të Frymës së Shenjtë në trajtimin e qëndrimeve dhe emocioneve që ata kanë dhe që mund të dëmtojnë marrëdhëniet e tyre.



Dëgjoni programin "Shpresë për ty" në:

Radio 7: 97,7 FM: të shtunën ora 8:30

Radio Emanuel: 95,7 FM të shtunë ora 9:00

Radio Logos: 94,2 FM të shtunë/ të dielë ora 9:00 dhe 17:00

Tendencat e martesës në mbarë botën janë shumë komplekse. Në shumë vende, të rriturit po zgjedhin të mos martohen. Bashkëjetesa është në rritje, poligamia praktikohet ende dhe braktisja dhe divorcet janë zgjidhje të lehta për shumë njerëz. Mjerisht, disa kultura vazhdojnë t'i lejojnë prindërit të detyrojnë vajzat në martesë dhe t'u lejojnë burrave të moshuar që t'i divorcojnë me lehtësi këto nuse të reja që nuk kanë të drejta.

Megjithatë, pikëpamja e Perëndisë për martesën nuk ka ndryshuar që nga krijimi. "Për këtë arsye njeriu do të braktisë babanë dhe nënën e tij dhe do të bashkohet me gruan e tij, dhe do të jenë një mish i vetëm." (Zanafilla 2:24). Ndërsa mëkati ka shkatërruar pastërtinë e martesës, Perëndia vazhdon të punojë brenda dhe nëpërmjet nesh për të ndihmuar në ndërtimin e martesave që e nderojnë atë. Shëmtia e imoralitetit seksual, pornografia, lakmia, abuzimi me alkoolin, egoizmi, braktisja, abuzimi fizik dhe verbal dhe sjelljet e tjera të dëmshme krijojnë shumë pengesa për martesë të forta dhe të shëndetshme.

Martesa, si çdo marrëdhënie midis dy njerëzve, përfshin vendosmëri dhe përkushtim. Duhet përpjekje e madhe për të zhvilluar një marrëdhënie martesore në mënyrë që dy njerëz të pjekur individualisht të bëhen më të afërt me gëzimet dhe vështirësitë e jetës. Të dy bashkëshortët duhet të jenë të vetëdijshëm për pikat e forta dhe dobësitë e tyre dhe të marrin përgjegjësinë për qëndrimet dhe veprimet e tyre. Nuk mund t'i ndryshojmë njerëzit e tjerë; ne mund të ndryshojmë vetveten.

Për ata që martohen, zgjedhja e partnerëve të jetës është një nga vendimet më të rëndësishme që do të bëjnë ndonjëherë. Duke pasur të njëjtin botëkuptim (kulturë, fe etj.) me siguri procesi i dy jetëve që bëhen një do të jetë shumë më i lehtë. Gjithashtu është e rëndësishme që të kemi pikëpamje të përbashkëta në lidhje me çështjet si pasuria, financat, fëmijët, arsimi dhe marrëdhëniet me familjen e zgjeruar.

Një përkushtim i fortë ndaj Perëndisë dhe një qëndrim i përlur i varësisë ndaj punës së Shpirtit të Shenjtë në jetën tonë mund të ndihmojë në forcimin e marrëdhënieve martesore në mënyrë që ta nderojnë Perëndinë.

Të lutemi për martesë të perëndishme



Programi "Shpresë për ty" transmetohet në 73 gjuhë. Kërkesat mujore të lutjes përdoren në 100 gjuhë. Dëgjoni kalendarin e lutjes online në: twr-albania.com.

Të lutemi për ...

1. Urtësi për 73 skuadrat prodhuese të “Shpresë për ty”, ndërsa mësojnë parimet e Perëndisë lidhur me martesën dhe marrëdhëniet familjare.
2. Çiftet e martuara që të zhvillojnë aftësi të mira komunikimi dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin për t’u marrë me acarimet dhe emocionet që mbarten rrugës në zgjidhjen e problemeve.
3. Çiftet që vuajnë hidhërimin pasi kanë përjetuar dështimet gjatë shtatëzanisë ose vdekjet e fëmijëve. Shpesh këto tragjedi çojnë në divorc.
4. Prindërit që t’u mësojnë fëmijëve të tyre se zgjedhja e bashkëshortit është një vendim i rëndësishëm, sepse ndihmon në përcaktimin e të ardhmes së çiftit të martuar dhe të fëmijëve që ata sjellin në jetë. Prindërit mund t’u tregojnë se si përcaktimi i qëllimeve do t’i ndihmojë në udhëheqjen e këtij vendimi.
5. Prindërit dhe edukatorët të mësojnë adoleshentët se abstinenca nga seksi deri në martesë u lejon atyre të kenë jetë dhe marrëdhënie më të shëndetshme
6. Gratë beqare të krishtera të kenë forcë dhe urtësi për t’i bërë ballë pengesave dhe vështirësive për të mos u martuar dhe për të lulëzuar në ecjen e tyre me Perëndinë. (1 Korintasve 7:38)
7. Gratë që i lejojnë burrat e tyre t’i abuzojnë verbalisht ose fizikisht sepse as vetë ato nuk respektojnë veten e tyre madje ndihen se nuk meritojnë të jenë për tu dashur.
8. Vejushat, gratë e braktisura dhe nënat e vetme që duhet të sigurojnë për nevojat e fëmijëve të tyre. Lutuni që komunitetet të bëjnë më shumë për t’i mbrojtur këto gra.
9. Prindërit e krishterë të respektojnë personat me të cilët fëmijët e tyre të rritur kanë zgjedhur të

martohen dhe të flasin mirë për ta, ndërsa kërkojnë mënyra për të nderuar martesat e tyre.

10. Gratë e reja që po konsiderojnë të jetojnë me të dashurit e tyre. Lutuni që ato do të respektojnë veten dhe do të presin për burra të cilët do të angazhohen t’i duan ato mes gëzimeve dhe sfidave të jetës.

11. Ligje që duhet të miratohen dhe zbatohen në shumë vende për t’i ndaluar prindërit që të detyrojnë vajzat e tyre të martohen me njerëz të moshuar - ndonjëherë 10 deri në 30 vjet më të vjetër.

12. Besim të thellë dhe të palëkundur për gratë e krishtera që jetojnë me burra jo të krishterë. Kërkoni që Fryma e Shenjtë t’i bindë këta burra që të pranojnë dhuratën e shpëtimit të Perëndisë.

13. Gratë që, pa dashje, dëshirojnë vëmendjen fizike të burrave, duke i çuar ata t’i dorëzohen mëkatit seksual. Kërkojini Zotit t’u zbulojë atyre fuqinë e dashurisë së tij në kapërcimin e tundimit. (Psalmi 73:26)

14. Burrat e krishterë që kanë gra jo të krishtera. Lutuni që dashuria dhe butësia e tyre ndaj grave të tyre do t’i çojnë gratë të jenë të hapura për dashurinë dhe dhuratën e shpëtimit të Perëndisë.

15. Prindërit dhe udhëheqësit e kishës për t’u mësuar të rinjve rreth rreziqeve të pornografisë, që shkatërron bukurinë e vërtetë të marrëdhënieve fizike. (1 Thesalonikasve 4: 3-5)

16. Prezencën intime të Perëndisë që të përjetohet nga gratë të cilat e ndiejnë vetminë e thellë të braktisjes nga burrat e tyre ose të cilat nuk janë martuar kurrë.

17. Gratë që të mësojnë se edhe pse vetmia është e vështirë, është më mirë të mos martohesh sesa të jetosh me burra që nuk i respektojnë ato ose Zotin e tyre dhe që mund të ndikojnë negativisht mbi fëmijët e tyre.

18. Viktimat e dhunës në familje. Lutuni që çdo burrë të kuptojë se Perëndia e ka bërë gruan të jetë partnerja e burrit dhe se ai duhet ta dojë, respektojë dhe ta mbrojë gruan e tij.

19. Nuset që nuk mund t’i plotësojnë kërkesat e pajës së familjeve të burrave. Raste të tilla ne lidhje me pajën e nuses ndonjëherë sjellin tortura, vrasje ose vetëvrasje.

20. Gratë në shërbesë të inkurajohen dhe ta njohin fuqinë dhe praninë e Perëndisë. Shumë nga këto gra mbajnë një peshë të rëndë të përgjegjësive të shërbesës, punës dhe familjes.

21. Të krishterët të ruajnë mendimet e tyre dhe të zgjedhin me kujdes atë çfarë lexojnë, shikojnë dhe dëgjojnë. “Së fundi, vëllezër, të gjitha gjërat që janë të vërteta, të gjitha gjërat që janë të ndershme, të gjitha gjërat që janë të drejta, të gjitha gjërat që janë të pastra, të gjitha gjërat që janë të dashura, të gjitha gjërat që janë me famë të mirë, nëse ka ndonjë virtyt dhe nëse ka ndonjë lëvdim, këto mendoni.” (Filipianëve 4: 8).

22. Fëmijët që shikojnë prindërit e tyre në marrëdhënie abuzive. Shumë prej tyre do të bëhen burra abuzivë ose gra të ndrojtura që pranojnë abuzimin si diçka normale.

